

Data 15/11/2023

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MONITORIMI I TREGUESVE MJEDISOR NË NJËSITË E PRODHIMIT”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): SHËRBIME MJEDISORE - 90700000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,030,000 (GJASHTË MILION E TRIDHJETË MIJË) LEKË PA TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklaratimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë përmbushet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit të përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është një kërkesë e mbështetur në pikën 4 të nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi. Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë laborator fiziko kimik të akredituar:

1. Sipas standartit S SH ISO IEC 17025:2017, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.
2. Vlefshmëria e çertifikatës së akreditimit duhet të jetë deri në përfundimin e kontratës objekt prokurimi.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e akreditimit që të vërtetojë disponimin e laboratorit (në pronësi).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për të vërtetuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Kërkesa teknike se Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi laborator fiziko kimik të akredituar, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, është përcaktuar në përputhje me specifikimet e objektit të kontratës dhe kërkesa e laboratorit fiziko kimik të akredituar është kërkuar për të vërtetuar se operatori/ët ekonomik disponojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të kësaj kontrate, për të garantuar një shërbim me cilësi.

Kërkesa në lidhje me standartin S SH ISO IEC 17025:2017, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi është kërkuar në përputhje me nenin 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Kërkesa Teknike se Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025, është një kërkesë në përputhje e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Analizat janë mjaft specifike dhe kërkesa e laboratorit të akredituar është kërkuar për të vërtetuar se operatori/ët ekonomik disponojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të kësaj kontrate, për të garantuar një shërbim me cilësi. Nevoja e analizave laboratorike kërkohet duke parë specifikën që ka monitorimi i këtyre faktorëve mjedisorë në të 3 (tre) njësitë e prodhimit. Standardi S SH ISO/IEC 17025 i kërkuar vërteton se operatorët ekonomik ofertues janë të certifikuar dhe akredituar për të kryer analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”, është e nevojshme për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse produktet dhe shërbimet e marra nga furnitorët janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001:2015 “Sistemi i Menaxhimit Mjedisor”, është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e operatorit ekonomik ofertues duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

2.3.4 (a) Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën:

- Minimalisht 1 (një) ekspert në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedis. (Preferohet të jetë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë);
- Minimalisht 2 (dy) ekspertë në fushën e kimisë. (Preferohet të jenë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë);
- Minimalisht 1 (një) specialist në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedis. (Preferohet të jetë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë);

(b) Minimalisht eksperti ose specialisti në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedis, duhet të jetë i pajisur me çertifikatë për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

1. *Diplomë;*
2. *CV;*
3. *Çertifikata;*
4. *Listpagesa E-Sig për periudhën Tetor 2023.*

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kërkesa për punonjësit e kërkuar si ekspertë dhe specialistë në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedisi, ekspertë në fushën e kimisë dhe 1 (një) ekspertë ose specialistë të jetë i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, lëshuar nga Ministria e Mjedisit, lidhet ngushtë me detyrat që do të kryejnë gjatë monitorimit në të 3 (tre) njësitë e prodhimit në përputhje me specifikimet teknike.

Monitorimi mjedisor është një proces specifik i cili kërkon njohje të shumëanëshme të natyrës, shkaqeve dhe çështjeve të veçanta të ndotjes së mjedisit. Për këtë qëllim është kërkuar kërkesa për punonjësit e kërkuar si ekspert në fushën e mjedisit inxhinier mjedisi ose agromjedisi, kimisë dhe 1 (një) punonjës të certifikuar për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor, pasi duhet të kenë njohuri lidhur me mënyrën se si menaxhohet një monitorim mjedisor, njohuri të shumëanëshme të mjedisit, metodikës etj.

Bazuar sa më sipër, si dhe referuar natyrës së kontratës, shërbimeve dhe detyrimeve specifike të kërkuara, lind nevoja për kërkesën për punonjësit e kërkuar si ekspert në fushën e mjedisit inxhinier mjedisi ose agromjedisi e kimisë dhe 1 (një) punonjës të certifikuar për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor.

Gjithashtu referuar legjislacionit dhe në mënyrë specifike, VKM nr.1124, datë 30.7.2008 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, auditimin mjedisor”, i ndryshuar ", për kryerjen e veprimtarisë objekt prokurimi, është i nevojshëm disponimi i 1 (një) punonjës të certifikuar për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e analizave për të cilat laboratorit është i akredituar të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për të vërtetuar përshtatshmërinë për të kryer

veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik pjesëmarrës. Duke qene se analizat janë mjaft specifike, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme:

1. Aparat për matjen e zhurmave Klasi 1 dhe kalibruesi;
2. Pajisje për matje të grimcave PM10, PM 2.5 në ajër;
3. Spektrofotometër për analizat e ujit;
4. Analizator gazesh për matje në ajër;
5. Bombël kalibrimi për paisjen e gazeve;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit.

Pajisjet e mësipërme duhet të shoqërohen me çertifikatën e kalibrimit;

Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh. Faturë tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuar.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet si aparat për matjen e zhurmave Klasi 1 dhe kalibruesi; pajisje për matje të grimcave PM10, PM 2.5 në ajër; spektrofotometër për analizat e ujit; analizator gazesh për matje në ajër; bombël kalibrimi për paisjen e gazeve janë kërkuar në përputhje me kërkesat teknike dhe shërbimet që kërkohen të kryhen sipas Specifikimeve teknike.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) mjete transporti.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

1. Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose marrjen me qira;
2. Leje qarkullimi;
3. Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;
4. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet e transportit janë kërkuar gjithashtu duke parë edhe vendin se ku do kryhen këto shërbime pasi monitorimi sipas specifikimeve teknike do të kryhet në Njësitë e Prodhimit Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njësimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

KESH sh.a. ka në administrim kaskadën më të madhe në rajon me një sipërfaqje ujëmbledhëse në Lumin Drin, e cila vlerësohet të jetë 14,173 km² më një gjatësi të rrjedhës prej 285 km. KESH ka nën administrim impiantet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend dhe si veprimtari themelore prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj.

HEC Fierza është hidrocentrali i sipërm i kaskadës së lumit Drin. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, Fierza luan rol kyç për shfrytëzimin, rregullimin dhe sigurinë e gjithë kaskadës dhe ka një fuqi të instaluar prej 500 MW (4 x 125 MW).

HEC Koman është hidrocentrali i dytë dhe më i fuqishëm i kaskadës së lumit Drin. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, ky HEC luan rol kyç për prodhimin dhe shfrytëzimin e të gjithë kaskadës. Komani është hidrocentrali me kapacitetin më të madh të prodhimit të energjisë në vendin tonë dhe ka një fuqi të instaluar prej 600 MW (4x150 MW).

HEC Vau i Dejës është hidrocentrali i parë që u ndërtua mbi lumin Drin dhe ka një fuqi të instaluar prej 250 MW. Ai ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, në rrjedhën e poshtme të lumit Drin, në Grykën e Vaut të Dejës, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës.

Me miratimin e marrëveshjes së huasë me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Ristrukturimi i KESH sh.a.”, që prej vitit 2016, KESH ka nisur aplikimin dhe zbatimin e procedurave të Sistemit të Menaxhimit të Integruar të sistemeve të mëposhtme, të cilat janë detyrim i kësaj marrëveshjeje .

UNI EN ISO 9001- Sistemi i menaxhimit të cilësisë;

UNI EN ISO 14001 - Sistemi i menaxhimit të mjedisit;

Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 kërkon që:

- Aktivitetet në njësitë prodhuese të shoqërisë të jenë në përputhje me ligjet dhe kërkesat mjedisore në fuqi;*
- Shoqëria menaxhon në mënyrë rigoroze impaktet për një zhvillim të qëndrueshëm të performancës mjedisore;*
- Shoqëria trajnon dhe ndërgjegjëson punonjësit për menaxhimin e impakteve gjatë aktiviteteve në njësi.*

✚ KESH sh.a. është e angazhuar, për këtë arsye, për të siguruar disponueshmërinë e burimeve dhe informacionit të nevojshëm për të arritur rezultatet e planifikuara përmes zbatimit të masave që kanë për qëllim monitorimin, matjen dhe analizimin e proceseve të identifikuara.

✚ Specifikimet Teknike janë përgatitur me qëllim vlerësimin e disa prej treguesve mjedisorë, që duhet të kryhet nga laboratorë të specializuar dhe të akredituar. Rezultatet e analizave do t'u bashkohen procedurave të 140001, me qëllim marrjen e këtij çertifikimi, duke filluar me Auditimin Çertifikues Fillestar.

Njësia e Prokurimit